

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fama e ka bërë të palumtur, Vozinha: Dua jetën e thjeshtë që kisha – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/fama-e-ka-bere-te-palumtur-vozinha-dua-jeten-e-thjeshte-qe-kisha/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:35:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:32:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	648160cddd954e50da1aa606817add5228d591ccb19222152c2de7af6cda85a7
TEKSTI	224360e0c7b5ab2a276e65749c0e2f55107692aae281c60ac7fd7b31c48e1db3
PAMJA	430180d41d33a71da4d124f7f0242f3721e532db8c1b06303f7a472522baa7a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ad0f179ff1799e508bd3b0001defa9ff7f476caf12fd1d5770f20bed8c3c2851
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ad0f179ff1799e508bd3b0001defa9ff7f476caf12fd1d5770f20bed8c3c2851>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Kupa e Botës 2026 i ndryshoi përgjithmonë Jetën portierit të Kepit të Gjellbër, Vozinha. Por ajo që për shumë njerëz do të ishte një ëndërr e realizuar, për 40-vjeçarin ka sjellë edhe një kosto të madhe: humbjen e qetësisë dhe privatësisë.

Në një intervistë për The Observer, Vozinha, emri i vërtetë i të cilit është Josimar Jose Evora Dias, pranoi hapur se, nëse do të kishte mundësi të zgjidhte mes jetës së sotme dhe asaj që kishte para Botërorit, do të rikthehej te jeta e mëparshme.

“Kam humbur paqen dhe qetësinë. Nuk kam më privatësi, ose të paktën kam shumë më pak se më parë. Tani dal, shkoj në një restorant dhe gjithmonë ka dikush që kërkon një foto, një autograf ose më filmon”, rrëfeu portieri.

Vozinha hyri në Botërorin e SHBA-së, Kanadasë dhe Meksikës me vetëm rreth 50-56 mijë ndjekës në Instagram. Gjithçka ndryshoi pas ndeshjes së parë ndaj Spanjës, ku ai shkëlqeu me shtatë pritje dhe ndihmoi Kepin e Gjellbër të merrte një barazim historik 0-0.

Një thirrje nga transmetuesi brazilian CazeTV bëri që miliona njerëz ta ndiqnin në rrjetet sociale. Brenda pak orësh, Vozinha kaloi shifrën e një milion ndjekësve, ndërsa pas përfundimit të turneut numri u rrit në dhjetëra miliona, duke e kthyer atë në një prej personazheve më të ndjekur të futbollit në Instagram.

Në fushë, ai vazhdoi të shkëlqente. Kepi i Gjellbër nuk humbi asnjë

5 Menaxhon 20 apartamente me qira ditore, ja cila është leverdia e këtij...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

nga ndeshjet e tij në 90 minuta gjatë Botërorit dhe Vozinha u bë veçanërisht i famshëm pas paraqitjes kundër Argjentinës, ku realizoi tetë pritje, përfshirë disa ndaj Lionel Messit.

Por pas përfundimit të turneut, fama vazhdoi të ndiqte çdo hap të tij.

“Shumë njerëz duan të jenë të famshëm, por shohin vetëm anën pozitive të kësaj jete. Për të qenë i sinqertë, nëse do të më ofronin jetën që kam sot ose jetën që kisha më parë, do të zgjidhja atë që kisha më parë”, deklaroi Vozinha.

Megjithatë, portieri nuk e sheh famën vetëm në mënyrë negative. Ai shpreson që vëmendja globale që mori Kepi i Gjelbër gjatë Botërorit të sjellë përfitime edhe për vendin e tij.

“Është mirë të ndihem si një lloj ambasadori, por ajo që arritëm ishte rezultat i një përpjekjeje kolektive”, tha ai, duke theksuar se suksesi i kombëtares mund të përdoret për të promovuar vendin dhe për të krijuar mundësi të reja për njerëzit e tij.

Nga një portier pothuajse i panjohur jashtë Kepit të Gjelbër, Vozinha u kthye brenda pak javësh në një figurë globale. Por pas miliona ndjekësve, fotografive dhe vëmendjes së vazhdueshme, ai tashmë e di se fama ka edhe anën e saj të padukshme: jeta e thjeshtë që kishte dikur nuk ekziston më në të njëjtën mënyrë.

#futboll

#vozinha



WRITTEN BY
Adnand Kolgjokaj
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →


Vazhdo të lexosh



SPORT

Skuadrat angleze i kanë vënë syrin, Int...

Adnand Kolgjokaj 28 Sht 10:16



SPORT

Bota e wrestling-ut në zi, mundësi ndahet...

Redaksia Web 28 Sht 09:35



SPORT

Haaland shënon, por Portugalia feston,...

Adnand Kolgjokaj 27 Sht 22:54

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.